


NJË VËSHTRIM MBI TREGUESIT E ZHVILLIMIT EKONOMIK TË SHQIPËRISË

SEKRETARIATI I KËSHILLIT TË INVESTIMEVE
Dhjetor 2017

Shënim: Materiali është vetëm një përmbledhje e disa prej treguesve kryesorë dhe nuk përfaqëson opinionet apo pikëpamjet e Sekretariatit dhe Këshillit të Investimeve.

Të dhënat e përdorura në prezantim janë gjeneruar nga databazat e faqeve zyrtare të Institutit Shqiptar të Statistikave, Bankës së Shqipërisë, Bankës Botërore, Fondit Monetar Ndërkombëtar, etj.


Ecuria e Rritjes Ekonomike



Burimi: IMF International Monetary Fund, World Economic Outlook Database, April 2016. Pas vitit 2012 vlerësimet janë parashikime.

Pas një ecurie të rritjes mesatarisht me 6% për periudhën 2000-2008, Shqipëria ndjeu pasojat e krizës globale financiare me një nivel të rritjes ekonomike në rënie me pritshmëri për rritje nga viti 2015 e më tej. Qeveria Shqiptare (Kuari Makro-Ekonomik Fiskal 2015-2017) dhe FMN parashikon një rritje ekonomike për 2016 në nivelin 3.4%.


E ardhura për Frymë në Vite



*Burimi: International Monetary Fund, World Economic Outlook Database, April 2016.
Të dhënat pas 2010 janë vlerësime paraprake.*

E ardhura për frymë e Shqipërisë për vitin 2016 vlerësohet në 4523 USD korrent dhe 11822 USD sipas paritetit të fuqisë blerëse (PPP).

Kontributi i Sektorëve në Rritjen Ekonomike (në %)




Burimi: INSTAT, Dhjetor 2016 Llogaritë Kombëtare Vjetore (Metoda e Prodhimit), * finale dhe ** paraprake


Ekonomia Shqiptare është një ekonomi e orientuar kryesisht nga shërbimet (me rreth 63% në total), bujqësia (me rreth 20%), ndërtimi (rreth 10%) dhe industria (me kontributin modest të industrisë nxjerrëse dhe përpunuese në rreth 5%). Sektorët në rritje të lehtë për 2015 kanë qenë bujqësia dhe ndërtimi.

Eksportet & Importet e Shqipërisë sipas grup-mallrave në vite në million lekë

Eksporte




Importe



Burimi: INSTAT, Tregtia e Jashtme sipas Produkteve 1993- 2016 ne million leke

Eksportet janë të orientuara nga produktet fason dhe minerale, energji elektrike dhe lëndë djegëse. Ne importe zërin kryesor e zënë ushqimet, makineri dhe minerale e lëndë djegëse.


EKSPORTET NË SHËRBIME – Konteksti Rajonal, 2015



Të dhënat nga database: World Development Indicators. Azhornimi i fundit 01.02.2017

Shqipëria ka vlerë të konsiderueshme të eksporteve në shërbime, e dyta në rajon (mbas Serbise) por në nivel shumë të ulët eksporti në shërbimet në teknologji informacioni.

Ndryshimet vjetore të Indeksit të Cmimit të Konsumit




Burimi: INSTAT, Mars 2016


Inflacioni përgjatë viteve ka qenë i ulët dhe poshtë kufirit maksimal të politikës monetare 4 %.

Forca e Punës sipas Grup-moshave

Shkalla e pjesëmarrjes në forcën e punës (%)



Papunësia në %




Burimi: INSTAT, Anketa Tremujore e Forcave të Punës, Tr.1.2012-Tr.4.2016

Papunësia tek të rinjtë ka ardhur në rritje, për 2015 - 2016 duke arritur në 28% të forcës së punës së kësaj grup moshe.

Paga Mesatare sipas Sektorëve


Në Lek



Burimi: INSTAT, Anketa Strukturore e Ndërmarrjeve 2010 - 2014

Sektorët me pagat më të larta janë Industria nxjerrëse dhe Transporti, Informacioni dhe Komunikimi, të vendosur dukshëm mbi mesataren e pagave.


Kosto e Punës për Vendet E Ballkanit Perëndimor, 2015 (EUR)



Burimi: Zyrat Statistikore te Vendeve, per Shqiperine paga mesatare ne administraten publike për 2015.


Shqipëria renditet dukshëm poshtë vendeve të Ballkanit për koston e punës për pagën mesatare dhe e krahasueshme me vendet e tjera për koston e punës për pagën minimale. 11

Investimet Publike dhe Private në Shqipëri (në përqindje të PBB-së)



Burimi: Ministria e Financave, Banka e Shqipërisë


Investimet sipas Sektoreve



- Energjia elektrike, gazi, uji dhe trajtimi i mbetjeve, aktivitetet me investimet më të mëdha.
- Ka rënie të ndjeshme të investimeve në industrinë përpunuese në 2014, me një rikuperim të investimeve gjatë 2015 në këtë sektor.
- Investimet në Shërbime kanë rritjen më të lartë për vitin 2015.

Burimi: INSTAT – Anketa Strukturore e Ndermarrjeve per vitet respektive


Prurjet e Investimeve të Huaja Direkte



Burimi: World Development Indicator, July 2016

Ndonëse prurjet e IHD kanë ardhur në rënie në vlerë, në kontribut ndaj GDP kanë qënë më të qëndrueshme në përgjigje edhe të impaktit të krizës globale në vendet e origjinës dhe rënies ekonomike në vend. Sipas BSH për 2015 IHD vlerësohen në 923 million EUR, ndërsa për 2016 vlerësohen paraprakisht nga BSH në 977 million EUR.

Stoku i IHD-ve sipas shteteve per 2015




■ Greqi ■ Hollande ■ Kanada ■ Itali ■ Turqi ■ Austri ■ Te tjera

Burimi: Banka e Shqipërisë, Shtator 2016

Greqia, Hollanda, Kanada dhe Itali janë vendet kryesore të orgjinës së stokut të investimeve direkte të huaja për 2015.

Shpërndarja e stokut të IHD-ve sipas aktivitetit ekonomik për 2015




Burimi. Banka e Shqipërisë, Shtator 2016

Industria mbetet sektori kryesor ku janë orientuar IHD-të, por ka edhe një rritje të investimeve në pasuri të patundshme dhe informatikë, ndërkohë që ka rënie në ndërtim si një sektor në vështirësi në vitet e fundit në vend.


Fluksi i FDI-ve në Vendet e Ballkanit

Në USD korrente



Burimi: World Development Indicators

Në % ndaj PBB-së



Shqipëria renditet e dyta në rajon si për nga vlera e investimeve të huaja në vite ashtu edhe në kontributin në produktin e brendshëm bruto.


Stoku i Ndërmarrjeve dhe Profili 2010-2016

Sipas numrit të të punësuarve	Viti						
	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Gjithsej	103,038	109,039	106,837	111,083	112,537	152,288	160,679
1-4	92,798	97,836	95,520	99,782	101,025	136,470	145,456
5-9	5,018	5,194	5,636	5,235	5,387	8,172	7,631
10-49	4,078	4,744	4,439	4,660	4,647	5,994	5,902
50+	1,144	1,265	1,242	1,406	1,478	1,652	1,690
Prodhuësit e të mirave	16,049	17,099	16,413	16,842	16,989	37,950	48,585
1-4	12,198	12,991	12,592	13,071	13,273	33,255	44,179
5-9	1,791	1,717	1,718	1,565	1,603	2,080	1,865
10-49	1,649	1,923	1,650	1,681	1,562	1,971	1,877
50+	411	468	453	525	551	644	664
Prodhuësit e shërbimeve	86,989	91,940	90,424	94,241	95,548	114,338	112,094
1-4	80,600	84,845	82,928	86,711	87,752	103,215	101,277
5-9	3,227	3,477	3,918	3,670	3,784	6,092	5,766
10-49	2,429	2,821	2,789	2,979	3,085	4,023	4,025
50+	733	797	789	881	927	1,008	1,026

Burimi: Anketa e Ndërmarrjeve, INSTAT


Sektori privat përfaqësohet në masën dërrmuese, 99% nga biznesi i mesëm dhe i vogël, të orientuar kryesisht nga aktivitete në fushën e shërbimeve në rreth 75% të tyre.

Ndërmarrjeve Aktive sipas Aktivitetit Ekonomik - 2016




Burimi: Anketa e Ndërmarrjeve, INSTAT

Struktura e Punësimit sipas Aktivitetit Ekonomik dhe Madhësisë së Bizneseve



Sipas vlerësimeve të INSTAT për vitin 2016, rezulton se 41,2 % e të punësuarve janë të punësuar me pagë, 34,9 % janë të vetë-punësuar (punëdhënës ose të vetëpunësuar pa të punësuar të tjerë) dhe 23,9 % janë punëtorë pa pagesë në biznesin e familjes.


Pesha e të ardhurave buxhetore ndaj PBB-së në Vendet e Ballkanit



Burimi: IMF, World Economic Outlook, Prill 2016

Ndërkohë, Shqipëria paraqet peshën më të ulët të sektorit publik në ekonomi ndër vendet e rajonit.

Ecuria dhe Përbërja e Borxhit Publik ndaj PBB-së në vite




Burimi: Ministria e Financave, Kuadri Makroekonomik Fiskal, 2017 – 2019

Borxhi publik mbetet i lartë dhe konsolidimi fiskal mbetet domosdoshmëri në vijim.

Taksat Kryesore

- ❑ Tatimi mbi Vleren e Shtuar - 20%
- ❑ Tatimi mbi Fitimin, Xhiro Vjetore
 - a) 0-5 milion leke ($\approx$ 36,500 EUR) – 0%
 - b) Mbi 5 milion – 8 million Leke ($\approx$ 58,400 EUR) – 5%
 - c) Mbi 8 million Leke – 15%
- ❑ Tatimi mbi Dividentin – 15%

Renditja e Vendeve të Ballkanit Perëndimor në Treguesin e Lehtësise së të Bërit Biznes



Burimi: <http://www.doingbusiness.org/data/exploreeconomies/>

1 = më e lehtë në 190 = më e vështirë

Renditja e Shqipërisë në Raportet dhe Indekset Ndërkombëtare

Indeksi/ Raporti	Organizata	2014/2015	2015/2016	2016/2017	2017/2018
Perceptimi i Korrupsionit	Transparenc y International	110 (nga 175 vende)	88 (nga 168 vende)	83 (nga 176 vende)	
Liria Ekonomike	The Heritage Foundation	54 (nga 178 vende)	63 (nga 178 vende)		
Doing Business	Banka Boterore	62 (nga 189 vende)	97 (nga 189 vende)	58 (nga 190 vende)	65 (nga 190 vende)
Indeksi i Konkurruesh merise Boterore	Forumi Ekonomik Boteror	97 (nga 144 ekonomi)	93 (nga 140 ekonomi)	80 (nga 138 vende)	75 (nga 137 vende)
Vendet me te mira per te bere Biznes	Forbes Magazine	-	69 (nga 144 vende)		

Indikatorët e *Doing Business*

Indikator	2015	2016	2017	2018
Të fillosh një Biznes	54	58	46	45
Të marrësh një Leje Ndërtimi	122	189	106	106
Të marrësh Energji Elektrike	159	162	156	157
Regjistrimi i Pronës	104	107	106	103
Të marrësh Kredi	36	42	44	42
Mbrotja e Investitorëve Minoritare	18	8	19	20
Të Paguash Taksat	130	142	97	125
Tregtia ndërmjet Kufijve	37	37	24	24
Zbatimi I Kontratave	96	96	116	120
Zgjidhja e Aftësisë Mospaguese	40	42	43	41

Indikatorët më problematikë për vendin vazhdojnë të jenë, aksesimi në energji elektrike, lejet e ndërtimit, procedurat fiskale dhe regjistrimi i pronës. Në përmirësim regjistrimi i biznesit, mbrotja e investitorëve në minorancë dhe tregtia ndërmjet kufijve.

Tregtia përtej Kufijve - DB 2018

Koha dhe Kosto e eksportit

	Shqipëria	Europa & Azia Qëndrore
Koha - kontrolli në kufi (orë)	9	28
Kosto - kontrolli në kufi (USD)	55	191,4
Koha - përgatitja dhe kontrolli i dokumentave (orë)	6	27,9
Kosto - përgatitja dhe kontrolli i dokumentave (USD)	10	113,8
Renditja - raporti 2018	Vendi 24 nga 190 ekonomi	

Indikatorët e Konkurrueshmërisë

Indikatori	2015/2016	2016/2017	2017/2018
Institucionet	103	76	68
Infrastruktura	90	91	94
Mjedisi Makroekonomik	122	93	75
Arsimim dhe Shëndet Parësor	62	33	36
Arsimi i Lartë dhe Trajnimet	60	42	49
Efienca e Tregut të të mirave	93	69	57
Efienca e Tregut të Punës	93	98	91
Zhvillimi i Tregjeve Financiare	114	94	81
Gadishmëria Teknologjike	91	82	78
Madhësia e Tregut	105	109	105
Sofistikimi i Biznesit	104	94	74
Inovacioni	120	109	87

Treguesit e Lirisë Ekonomike

Indikatori (renditur I 59-ti)	2016
Të Drejtat e Pronës	86
Liria nga Korrupsioni	113
Liria Fiskale	34
Shpenzimet Qeveritare	72
Liria e Biznesit	80
Liria e Punës	128
Liria Monetare	49
Liria e Tregtisë	37
Liria e Investimeve	50
Liria Financiare	19

Korrupsioni, tregu i punës, marrja e pronësisë janë ndër fushat që shikohen si më problematike në treguesin e lirisë ekonomike, ndërsa ambjenti financiar dhe i tregtisë shikohen si favorizuese për nxitjen e ekonomisë.

Renditja e Indikatoreve sipas *Forbes* për Vendet më të mira për Biznes

Indikatori	2015
Liria e Tregtisë	35
Liria Monetare	38
Të Drejtat e Pronësisë	114
Inovacion	118
Teknologjia	88
Burokracia	49
Mbrojtja e Investitorëve	8
Korrupsioni	99
Liria Personale	65
Barra e Taksave	109

Ambjenti ekonomik në vend vuan nga problemet e pronësisë, korrupsioni, barra e taksave dhe niveli i ulët i novacionit dhe teknologjisë.